

PËR RISHPALLJEN E THIRRJES PËR SHPREHJE INTERESI PËR ANËTAR TË KOMISIONIT TË SHOQËRISË CIVILE QË DO TË KRYEJNË VERIFIKIMIN PARAPRAK TË KANDIDATURAVE PËR ANËTARIN QË PËRFAQËSON SHOQËRINË CIVILE, NË KËSHILLIN E LARTË TË PROKURORISË

Bazuar në ligjin nr. 115/2016 datë 3.11.2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ka publikuar shpalljen e vendeve vakante dhe thirrjen për paraqitjen e shprehjes së interesit për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga anëtarët e organizatave të shoqërisë civile. Në zbatim të detyrimeve sipas pikës 10 të nenit 56, Avokati i Popullit ka shpallur dy herë thirrjen për shprehje interesi për anëtar të komisionit të shoqërisë civile, që do të kryejnë verifikimin paraprak të kandidaturave për anëtarin që përfaqëson shoqërinë civile, në Këshillin e Lartë të Prokurorisë.

Pas shpalljes së dytë, me përfundimin e afatit të shprehjes së interesit nga Organizatat e Shoqërisë Civile, Avokati i Popullit nisi procesin e verifikimit të plotësisë të kriterëve nga Organizatat që kishin shprehur interes për të qenë pjesë e komisionit të shoqërisë civile duke bërë publike emrat e organizatave të cilat plotësonin kriteret e përcaktuara ligjore.

Duke qënë se një nga organizatat e shoqërisë civile ka njoftuar heqjen dorë nga shprehja e interesit për pjesëmarrjen në komisionin e shoqërisë civile, gjë që krijon mungesën e kuorumit minimal të konkurrueshmërisë dhe përzgjedhjes së tyre, sipas dispozitave të ligjit nr.115/2016 datë 3.11.2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, konsiderohet e nevojshme rishpallja e thirrjes për shprehje interesi për anëtarë të komisionit të shoqërisë civile.

Organizatave të shoqërisë civile që kanë paraqitur tashmë shprehjen e interesit dhe kanë përmbushur kriteret e përcaktuara ligjore, nuk kanë nevojë të paraqesin një shprehje tjetër interesi pasi kandidatura e tyre do të konsiderohet e vlefshme për fazën tjetër të procesit.

Shprehja e interesit, duhet të paraqitet nga organizatat e shoqërisë civile brenda një afati **7 ditor** nga dita e publikimit të kësaj thirrjeje, dhe duhet të përmbajë dokumentacionin origjinal, ose të noterizuar, që vërteton plotësimin e kriterëve ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 54, të Ligjit nr.115/2016 datë 3.11.2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Kuvendi zgjedh 1 anëtar të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga anëtarët e organizatave të shoqërisë civile, të regjistruara sipas legjislacionit përkatës, të cilët punojnë në fushën e sistemit të drejtësisë ose të drejtave të njeriut dhe që kanë zbatuar projekte në këtë fushë të paktën 5 vitet e fundit”.

Shprehja e interesit dhe dokumentacioni përkatës që vërteton plotësimin e kërkesave të mësipërme ligjore, duhet të dorëzohen brenda datës **08.09.2023** në një nga formatet e mëposhtme:

- fizikisht ose në rrugë postare pranë institucionit të Avokatit të Popullit në adresën: Bulevardi “Zhan D’Ark”, nr. 2, Tiranë, ora: 08:30-16:30. Aplikimi në rrugë postare duhet të kryhet brenda afatit të përcaktuar për dorëzimin e dokumenteve, i cili duhet të vërtetohet me fletë-mandatin e lëshuar nga institucioni përkatës postar;

- nëpërmjet postës elektronike në adresën: info@avokatipopullit.gov.al.

Institucioni i Avokatit të Popullit, duke vlerësuar bashkëpunimin me organizatat e shoqërisë civile një bashkëpunëtor kyç në mbrojtjen e të drejtave të njeriut, nxitjen e standardeve më të larta të të drejtave

të njeriut dhe shtetit të së drejtës në vend, rithekson nevojën e pjesëmarrjes të sa më shumë organizatave të shoqërisë civile në këtë proces tepër të rëndësishëm për sistemin e drejtësisë.